



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 25 tetor 2021
Nr.ref.:RK 1875/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI131/21

Parashtrues

Qazim Binaku

**Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë
së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 648/20
të 27 janarit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Qazim Binaku nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson avokati Eset Berisha, nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), Rev. nr. 648/20, të 27 janarit 2021, të cilin parashtruesi i kërkesës e pranoi më 30 mars 2021.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 14 korrik 2021, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 26 korrik 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Safet Hoxha (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
7. Më 18 gusht 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 18 gusht 2021, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë që të dorëzojë fletëkthesën për të vërtetuar se kur i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës Aktvendimi i Gjykatës Supreme [Rev. nr. 648/20] i 27 janarit 2021.
9. Më 15 shtator 2021, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën për dorëzimin e Aktvendimit të Gjykatës Supreme [Rev. nr. 648/20] parashtruesit të kërkesës, me datën e dorëzimit 30 mars 2021.
10. Më 7 tetor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Procedurat e zhvilluara para vitit 1999 në lidhje me banesën që është objekt i kontestit

11. Më 30 maj 1980, Ndërmarrja Publike për Distribuimin e Energjisë Elektrike „Elektrokosmet“ (në tekstin e mëtejme NP „Elektrokosmet“) me aktvendimin [nr. 1222/58] i ndau banesën në shfrytëzim parashtruesit të kërkesës në cilësinë e punëtorit të NP „Elektrokosmet“.
12. Më 13 mars 1991, NP „Elektrokosmet“ me vendimin [nr. 827] anuloi aktvendimin [nr. 1222/58] të 30 majit 1980 për ndarjen e banesës për shfrytëzim për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës të parashtruesit të kërkesës.
13. Më 4 shkurt 1993, NP „Elektrokosmet“ me aktvendimin [nr. 193] ia ndau banesën për shfrytëzim J.F., një punëtori tjetër të NP „Elektrokosmet“.
14. Në një datë të pacaktuar në vitin 1993, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër dy të paditurve, J.F. dhe NP „Elektrokosmet“, duke kërkuar që në bazë të aktvendimit [nr. 1222/58] të 30 majit 1980, NP „Elektrokosmet“ t’ia dorëzojë banesën kontestuese për shfrytëzim. Me këtë padi, parashtruesi gjithashtu kërkoi nga Gjykata Komunale që ta obligojë të paditurin J.F. që ta lironte banesën kontestuese.
15. Më 20 shkurt 1996, Gjykata Komunale në Prishtinë, me aktgjykimin [P. nr. 718/93], miratoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe e detyroi të paditurin NP „Elektrokosmet“ që në bazë të aktvendimit [nr. 1222/58] të NP „Elektrokosmet“ të 30 majit 1980 t’ia dorëzojë banesën për shfrytëzim dhe e detyroi të paditurin J.F. që ta lirojë banesën nga njerëzit dhe sendet dhe t’ia dorëzojë atë në shfrytëzim parashtruesit të kërkesës.
16. Më 23 shkurt 1996, J.F. dhe NP „Elektrokosmet“ lidhën marrëveshje [VR. nr. 130/96] për blerjen e banesës kontestuese.
17. Në një datë të pacaktuar në vitin 1996, të paditurit J.F. dhe NP „Elektrokosmet“ parashtruan ankesë në Gjykatën e Qarkut kundër Aktgjykimit [P. nr. 718/93] të Gjykatës Komunale në Prishtinë, për shkak të, *“shkeljeve esenciale të dispozitave të LKP-së, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale”*.
18. Më 19 dhjetor 1996, Gjykata e Qarkut, me aktvendimin [Gr. nr. 931/96], e miratoi ankesën e të paditurve J.F. dhe NP „Elektrokosmet“ duke anuluar aktgjykimin [P. nr. 718/93] të Gjykatës Komunale në Prishtinë të 20 shkurtit 1996 dhe e ktheu çështjen në gjykatën e shkallës së parë për rivendosje.

Procedurat e zhvilluara pas vitit 1999 në lidhje me banesën që është objekt i kontestit

19. Në çështjen juridike në lidhje me banesën e kontestuar pas vitit 1999, u zhvilluan dy procedura paralele, në të cilat parashtruesi i kërkesës ishte palë. Një procedurë u zhvillua pranë Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore (KKPB) të Drejtorisë për Çështje Pronësore Banesore (DÇPB-UN-Habitat), e cila funksiononte në kuadër të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Procedura e dytë u iniciua para gjykatave të rregullta në lidhje me banesën e kontestuar. Prandaj, Gjykata do t'i paraqesë këto dy procedura veç e veç në përmbledhjen e saj të fakteve.

Procedura pranë Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore (KKPB) pranë DÇPB -UN-Habitat

20. Në një datë të papërcaktuar, parashtruesi i kërkesës dhe pala e tretë J.F. paraqitën kërkesa për vërtetimin e së drejtës pronësore ndaj banesës së kontestuar, pranë Komisionit për kërkesa pronësore banesore (KKPB), i cili funksiononte në kuadër të DÇPB-UN-Habitat.
21. Më 16 dhjetor 2005, KKPB, me vendimin grupor HPCC/D/234//2005/ A&C, me të cilin, ndër kërkesat e tjera që kishte proceduar në grup, procedoi edhe kërkesat e parashtruesit dhe të J.F.
22. Sa i përket kërkesës së parashtruesit, KKPB e klasifikoi kërkesën e tij në kërkesat e "kategorisë A" dhe e refuzoi me arsyetimin, "[...] edhe pse paraqitësit e kërkesave kanë qenë në banim të pronave për një kohë, ata kurrë nuk kanë lidhë kontratë mbi shfrytëzimin apo qiranë me NPB. Lidhja e kontratës mbi shfrytëzimin apo qiranë kërkohet në mënyrë që e drejta e banimit të jetë valide. Në rastet kur ka pasë banim për një periudhë të konsiderueshme kohore së bashku me dëshminë e pagesës së qirasë gjatë asaj kohe në Ndërmarrjen Publike Banesore (NPB), Komisioni konstaton se kontrata mbi shfrytëzim ka ekzistuar në një mënyrë (shih HPCC/D122312005A&C të datës 22 tetor 2005). Sidoqoftë, në këto raste paraqitësit e kërkesave nuk kanë sjell ndonjë dëshmi të pagesës së qirasë, dhe ato dëshmi nuk janë gjetur as në të dhënat e Ndërmarrjes Publike Banesore. Paraqitësit e kërkesave A për këtë arsye asnjëherë nuk e kanë fituar të drejtën e banimit dhe kërkesat duhet te refuzohen, [...], duke pasur parasysh mënyrën e parregullt sipas së cilës pronat në fjalë i janë ndarë paraqitësve të kategorisë C ose bartësve të së drejtës pronësore, ose paraardhësve të tyre, varësisht prej rastit, Komisioni mendon t'ia referojë, përcaktimin e zgjidhjes ligjore, nëse ka ndonjë, e cila mund të jetë në dispozicion të paraqitësit A sipas ligjeve të aplikueshme, gjykatës vendore kompetente. Sipas nenit 22.7 (g) të UNMIK/REG/200/60 dhe deri në atë datë, pra deri sa gjykata lokale të merr vendimin mbi këtë çështje, ehte e nevojshme që Komisioni t'i parandalojë paraqitësit ose bartësit të së drejtës pronësore, varësisht prej rastit, që t'iu transferojnë pronat e tyre personave te tjerë nëse një transfer i tillë është rezultat i zgjidhjes miqësore të kontestit ndërmjet palëve. Në mungesë të këtij urdhri, qëllimi i referimit të rasteve në gjykatat kompetente vendore mund të zbehet. Në të njëjtën kohë, është e padëshirueshme që një ndalim i tillë të

mbetet në fuqi nëse kategoria A i paraqitësit të kërkesës nuk ushtron aktivisht procedurat në gjykatën vendore. Për këtë arsye, dispozita është bërë për shfuqizimin e urdhrit nëse procedurat nuk vazhdojnë në gjykatën vendore kompetente brenda, 60 ditëve”.

23. *Sa i përket kërkesës së palës së tretë J.F., KKPБ klasifikoi kërkesën e palës së tretë J.F. në “kategorinë C” dhe e miratoi atë me arsyetimin,” [...] Në kërkesat e lidhura të kategorisë C të paraqitura në pjesën B të listës së bashkangjitur, paraqitësit e kërkesave kanë dëshmuar prima facie se kanë pasur të drejta pronësore pre apartamentet e kërkuara. Paraqitësit e kërkesave poashtu kanë dëshmuar se e kanë humbur posedimin e pronave të tyre gjatë rrethanave të shkaktuara nga fushata ajrore e NATO-s, dhe se nuk kanë hequr dorë me vullnetin e tyre nga e drejta pronësore. Rrjedhimisht, secila nga kërkesat i ka plotësuar kriteret e parapara në paragrafin 3 më lart. [...], Sa i përket atyre që u thanë më lart, Komisioni konstaton se kërkesat e kategorisë C kanë sukses, dhe se duhet të lëshohet urdhri si më lart. Ky urdhër zgjidh vetëm çështjen e posedimit. Ai nuk zgjidh asnjë të drejtë tjetër ligjore, çështje apo kontest lidhur me pronën që kërkohet. Në rastet kur ka më shumë se një pronar, urdhri nuk i cenon të drejtat e bashkëpronarëve“.*
24. *Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në KKPБ për rishqyrtimin e vendimit të tyre [HPCC/D/234//2005/ A&C] të 16 dhjetorit 2005.*
25. *Më 6 qershor 2006, KKPБ-ja nxori vendimin [HPCC/REC/71/2006] dhe refuzoi kërkesën e parashtruesit për rishqyrtimin e vendimit të mëparshëm të KKPБ-së si të pabazuar, duke vërtetuar plotësisht vendimin e KKPБ-së [HPCC/D/234//2005/ A&C] të 16 dhjetorit 2005.*

Procedura e zhvilluar në gjykatat e rregullta në lidhje me kërkesën për përtëritjen e procedurës kontestimore në lidhje me banesën e kontestuar

26. *Më 9 tetor 2003, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatën Komunale në Prishtinë kërkesë për përtëritjen e procedurës kontestimore në lëndën civile C. nr. 718/93 dhe në bazë të aktvendimit [Gr. nr. 931/96] të Gjykatës së Qarkut.*
27. *Më 14 tetor 2003, Gjykata Komunale në Prishtinë, me aktvendimin [C. nr. 718/93], e pranoi kërkesën e parashtruesit, duke deklaruar se shkresat e lëndës në këtë gjykatë kanë humbur gjatë luftës dhe për këtë arsye iu dha urdhër shkrimorese së gjykatës ta bëjë regjistrimin me numër të ri rendor në regjistrin e gjykatës.*
28. *Më 7 shtator 2006, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktgjykimin [C. nr. 1817/2003] miratoi kërkesëpadinë e parashtruesit, ashtu që anuloi aktvendimin e të paditurës NP “Elektrokosmet” nr. 193 të 4 shkurtit 1993, si dhe kontratën e qirasë, të lidhur midis ndërmarrjes Publike Banesore dhe të paditurit të dytë, nr. 1193/2482, të 26 nëntorit 1992, dhe kontratën për blerjen e banesës të lidhur në mes të NP “Elektrokosmet” dhe të paditurit J. F., VR. nr. 130/96 të 23 shkurtit 1996 dhe e detyroi NP “Elektrokosmet” që në bazë të*

vendimit të NP “Elektrokosmet”, [nr. 1222/58] të 30 majit 1980, t’ia dorëzojë banesën kontestuese në shfrytëzim parashtruesit të kërkesës.

29. Në një datë të pacaktuar, Korporata Energjetike e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KEK) si pasardhëse juridike e NP “Elektrokosmet” dhe i padituri J.F. parashtruan ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, kundër aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Komunale, duke pretenduar vërtetim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe kërkesëpadia të refuzohet si e pabazuar ose të anulohet dhe çështja të kthehet për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.
30. Më 12 mars 2007, Gjykata e Qarkut, me Aktvendimin [Ac. nr. 52/2007], aprovoi si të bazuar ankesën e të paditurve KEK dhe J.F. ashtu që anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë [C. nr. 1817/2003] të 7 shtatorit 2006 dhe e ktheu çështjen në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.
31. Më 30 qershor 2017, në procedurën e përsëritur, Gjykata Komunale në Prishtinë, me aktvendimin [C. nr. 607/07], hodhi poshtë si të palejueshme padinë e parashtruesit të kërkesës duke e deklaruar veten jokompetente, me arsyetimin se *“[...] gjykata duke u kujdesur për kompetencën, në pajtim me nenin 18.1 të LPK-së e në kuptim të dispozitës së nenit 3.1 të UNMIK-Rreg. nr. 2000/60, ku gjen se përcaktohet që: “Asnjë kërkesë për rikthimin e pronës banesore të humbur ndërmjet datës 23 mars 1989 dhe dt. 24 mars 1999, si pasojë e diskriminimit nuk mund ti parashtrohet asnjë gjyqi apo tribunali në Kosovë, me përjashtim të atyre kërkesave që janë në pajtim me Rregulloren e UNMIKL-ut 1999/23 dhe këtë Rregullore”. Ndërsa sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/23 për themelimin e Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore dhe Komisionit për kërkesa pronësore dhe banesore në nenin 1.1 të saj, gjykata gjen se përcaktohet që: “Drejtoria për Çështje Pronësore dhe banesore merret me drejtimin e të gjitha çështjeve për të drejtat e pronësisë në Kosovë, deri sa përfaqësuesi special i Sekretarit të Përgjithshëm vendos se organit e pushtetit vendor janë në gjendje ti kryejnë funksionet që i janë besuar kësaj Drejtorie”.*
32. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Komunale, duke pretenduar vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe kërkesëpadia të refuzohet si e pabazuar ose të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim.
33. Më 6 korrik 2020, Gjykata e Apelit, me aktvendimin [Ac. nr. 4949/17], refuzoi, si të pabazuar, ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi në tërësi aktvendimin [C. nr. 607/07] të Gjykatës Komunale të 30 qershorit 2017 me arsyetimin se, *“[...] Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që referuar shkresave të lëndës rezulton se këtu paditësi Qazim Binaku ka parashtruar kërkesë për të drejtat e tij pronësore në raport me banesën kontestuese, tek Drejtoria për Çështje Pronësore Banesore, ndërsa komisioni i kësaj drejtorie*

pas shqyrtimit të kësaj kërkesë ka marr vendimin nr. HPCC/D/234/2005/A&C, datë 16.12.2005, me të cilin është refuzuar kërkesa e paditësit si e pabazuar, ndërsa kërkesa e të paditurit të dytë ishte aprovuar. Gjithashtu paditësi kishte parashtruar ankesë në komisionin për rishqyrtim ndaj vendimit të komisionit që ka vepruar si shkallë e parë, ndërsa me vendimin për kërkesën e rishqyrtuar HPCC/REC/71/2006, datë 06.09.2006, ankesa e paditësit ishte refuzuar dhe ishte vërtetuar vendimi i shkallës së parë, duke e bërë edhe të formës së prerë dhe përfundimtar këtë vendim. Si rrjedhojë, referuar nenit 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 199/23, i cili shprehimisht thotë: 'Vendimet përfundimtare të Komisionit janë të detyrueshme për tu zbatuar dhe nuk janë subjekt i rishqyrtimit nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë , rezulton se çështja e ngritur me padi nga paditësi, më nuk mund të rishqyrtohet nga ana e gjykatave, pasi konsiderohet se e njëjta është zgjidhur me vendimet përfundimtare të komisioneve përkatëse të Drejtorisë për Çështje Pronësore Banesore, dhe atë në zbatim të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60. Se vendimet përfundimtare të komisionit të cekur më lartë, të cilat janë marr në përputhje me dy rregulloret e UNMIK-ut (199/13 dhe 2000/60), janë përfundimtare dhe konform nenit 2 parag. 7 të Rregullores 1999/13, të njëjtat nuk mund t'i nënshtrohen rishqyrtimit nga asnjë gjykatë apo organ administrativ në Kosovë [...]".

34. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
35. Më 27 janar 2021, Gjykata Supreme nxori aktvendimin E. Rev. nr. 648/20, me të cilin refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës, duke vërtetuar në tërësi aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 4949/17] të 6 korrikut 2020.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

36. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, me nxjerrjen e vendimit të kontestuar [Rev. nr. 648/20] të 27 janarit 2021, ka shkelur të drejtat dhe liritë e tij themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.
37. Lidhur me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës pretendon, para së gjithash, vendimet e gjykatave të rregullta janë nxjerrë me shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, duke deklaruar, "Të gjitha gjykatat e Republikës së Kosovës, në të tri shkallët e sistemit gjyqësor, kanë refuzuar të drejtën e palës për shqyrtuar dhe vendosur kërkesën e tij të ligjshme për kthimin e posedimit të pronës dhe kompenzimin e dëmit të shkaktuar me veprimet e jashtëligjshme gjatë kohës së zbatimit të masave të dhunshme në ndërmarrjen në të cilën pala ka qenë i punësuar. Arsyetimi i gjykatave se nuk mund të vendoset për një çështje, për

të cilën ka vendosur një herë Drejtoria për Çështje Pronësore sipas Rregullores nr. 2000/60 (res judicata) nuk ka mbështetje për shkak se me vendimin e kësaj Drejtorie, paditësi ishte drejtuar që të drejtën e tij ta realizoj pranë gjykatave lokale, ndërsa ishin vendosur edhe kufizime ndaj kundërshtarit të dytë (JF), të cilit ishte njohur e drejta për kthimin e posedimit, por i ishte ndaluar që të bartë pronësinë e banesës lëndore tek personat tjerë, përveç palës me zgjidhje miqësore”.

38. Përveç kësaj, parashtuesi i kërkesës arsyeton shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës si më poshtë, *“Gjykatat duke hedhur poshtë padinë si të palejueshme kanë shkelur të drejtën e palës për gjykim të drejtë të garantuar sipas nenit 31, par. 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe të drejtën e tij për mbrojtje të pronës, të garantuar me nenin 46, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Detyrimi i gjykatave për të zgjidhur çështjen kontestuese rrjedh në bazë të nenit 2, par. 3 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore”.*
39. Në fund, parashtuesi i kërkesës i kërkon Gjykatës që ta deklarojë kërkesën e tij të pranueshme dhe ta shpallë të pavlefshëm aktvendimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 648/20] të 27 janarit 2021 në lidhje me aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 4949/17] të 6 korrikut 2020 dhe aktvendimin e Gjykatës Themelore [C. nr. 607/07] të 30 qershorit 2017, si dhe ta kthejë rastin në rigjykim.

Pranueshmëria e kërkesës

40. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
41. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

42. Në vijim, Gjykata shqyrton nëse parashtuesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë siç përcaktohen në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individu mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“ Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

43. Sa i përket përmbushjes së këtyre kushteve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
44. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kushtet në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë, duke përfshirë edhe kushtin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Konkretisht, rregulli 39 (2) parasheh:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

45. Gjykata rikujton që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih rastin K104/21, parashtrues *Nexhmije Makolli*, aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26 shih gjithashtu rastin K1175/20, parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
46. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si „qartazi e pabazuar“ në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që mund të ngërthejë një kërkesë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’u referohet të njëjtave si

“pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime *“të shkallës së katërt”*; (ii) pretendime që kategorizohen si *“mungesë e dukshme ose evidente e shkeljes”*; (iii) pretendime *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*; dhe në fund, (iv) pretendime *“konfuze dhe të paqarta”*. (Shih: më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si *“qartazi e pabazuar”*, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si *“qartazi të pabazuara”*, Udhëzuesi Praktik i GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë i 31 gushtit 2019; pjesa III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 deri më 284 shih gjithashtu rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 27 si dhe rastin KI175/20, cituar më lart, paragrafi 38).

47. Në këtë kontekst, si dhe në tekstin në vijim, në mënyrë që të vlerësojë pranueshmërinë e kërkesës, përkatësisht në rrethanat e rastit konkret, vlerësimi nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 28).
48. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në thelb pretendon dy lloje të shkeljeve, përkatësisht: i) shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDN -së dhe ii) shkeljet e pretenduara të nenit 46 të Kushtetutës. Prandaj, Gjykata do t'i shqyrtojë këto pretendime ndarazi.

i) Lidhur me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 10 të DUDNJ-së

49. Gjykata vëren se thelbi i ankesës së parashtruesve të kërkesës qëndron në pretendimin se Gjykata Supreme dhe gjykatat e rregullta në tri instancat kanë shkelur nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së duke arsyetuar: *“Të gjitha gjykatat e Republikës së Kosovës, në të tri shkallët e sistemit gjyqësor, kanë refuzuar të drejtën e palës për shqyrtuar dhe vendosur kërkesën e tij të ligjshme për kthimin e posedimit të pronës dhe kompenzimin e dëmit të shkaktuar me veprimet e jashtëligjshme gjatë kohës së zbatimit të masave të dhunshme në ndërmarrjen në të cilën pala ka qenë i punësuar. Arsyetimi i gjykatave se nuk mund të vendoset për një çështje, për të cilën ka vendosur një herë Drejtoria për Çështje Pronësore sipas Rregullores nr. 2000/60 (res judicata) nuk ka mbështetje për shkak se me vendimin e kësaj Drejtorie, paditësi ishte drejtuar që të drejtën e tij ta realizoj pranë gjykatave lokale, ndërsa ishin vendosur edhe kufizime ndaj kundërshtarit të dytë (JF), të cilit ishte njohur e drejta për kthimin e posedimit, por i ishte ndaluar që të bartë pronësinë e banesës lëndore tek personat tjerë, përveç palës me zgjidhje miqësore.”*

50. Në lidhje me këtë, Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ -së, por duke marrë parasysh edhe karakteristikat e saj, siç përcaktohen në KEDNJ, si dhe parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht ka theksuar ndryshimin midis "*kushtetutshmërisë*" dhe "*ligjshmërisë*" dhe theksoi se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose interpretimin e gabuar dhe zbatimin e gabuar të ligjeve që pretendohet të jenë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla kanë mundur të shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose KEDNJ (shih në këtë kontekst dhe, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI128/18, Parashtrues: *Limak Kosovo International Airport J.S.C.*, "*Adem Jashari*", Aktvendim i 28 qershorit 2019, paragrafi 55; KI62/19, parashtrues: *Gani Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafët 56-57; KI110/19, parashtrues: *Fisnik Baftijari*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2019, paragrafi 40).
51. Gjykata gjithashtu vazhdimisht ka theksuar se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë gjetjet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e së drejtës materiale dhe se nuk mund të vlerësojë vetë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "*shkallës së katërt*", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. (Shih: në këtë drejtim, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih gjithashtu rastet KI128/18, të cituara më sipër, paragrafi 56; dhe KI62/19, të cituar më sipër, paragrafi 58).
52. Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës është vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike dhe interpretimi i gabuar i ligjeve të zbatueshme nga Gjykata Supreme dhe nga gjykatat e rregullta në të tri instancat.
53. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta arsyetuan në mënyrë të detajuar se pse nuk kanë mundur të vendosin për çështjen në fjalë dhe pse padia e parashtruesit të kërkesës ishte dorëzuar në gjykatat jokompetente.
54. Së pari, Gjykata Komunale në Prishtinë përmes aktvendimit [C. nr. 607/07], hodhi poshtë si të palejueshme padinë e parashtruesit të kërkesës duke e shpallur veten jokompetente, me arsyetimin se "[...] gjykata duke u kujdesur për kompetencën, në pajtim me nenin 18.1 të LPK-së e në kuptim të dispozitës së nenit 3.1 të UNMIK-Rreg. nr. 2000/60, ku gjen se përcaktohet që: "Asnjë kërkesë për rikthimin e pronës banesore të humbur ndërmjet datës 23 mars 1989 dhe dt. 24 mars 1999, si pasojë e diskriminimit nuk mund ti parashtrohet asnjë gjyqi apo tribunali në Kosovë, me përjashtim të atyre kërkesave që janë në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/23 dhe këtë Rregullore". Ndërsa sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/23 për themelimin e Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore dhe Komisionit për kërkesa pronësore dhe banesore në nenin 1.1 të saj, gjykata gjen se përcaktohet që: "Drejtoria për Çështje Pronësore dhe banesore merret me drejtimin e të gjitha çështjeve për të drejtat e pronësisë në Kosovë, deri sa

përfaqësuesi special i Sekretarit të Përgjithshëm vendos se organet e pushtetit vendor janë në gjendje ti kryejnë funksionet që i janë besuar kësaj Drejtorie “.

55. *Më tej, Gjykata e Apelit, përmes aktvendimit [Ac. nr. 4949/17], vërtetoi plotësisht aktvendimin [C. nr. 607/07] e Gjykatës Komunale të 30 qershorit 2017, me arsyetimin se, “[...] Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që referuar shkresave të lëndës rezulton se këtu paditësi Qazim Binaku ka parashtruar kërkesë për të drejtat e tij pronësore në raport me banesën kontestuese, tek Drejtoria për Çështje Pronësore Banesore, ndërsa komisioni i kësaj drejtorie pas shqyrtimit të kësaj kërkesë ka marr vendimin nr. HPCC/D/234/2005/A&C, datë 16.12.2005, me të cilin është refuzuar kërkesa e paditësit si e pabazuar, ndërsa kërkesa e të paditurit të dytë ishte aprovuar. Gjithashtu paditësi kishte parashtruar ankesë në komisionin për rishqyrtim ndaj vendimit të komisionit që ka vepruar si shkallë e parë, ndërsa me vendimin për kërkesën e rishqyrtuar HPCC/REC/71/2006, datë 06.09.2006, ankesa e paditësit ishte refuzuar dhe ishte vërtetuar vendimi i shkallës së parë, duke e bërë edhe të formës së prerë dhe përfundimtar këtë vendim. Si rrjedhojë, referuar nenit 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 199/23, i cili shprehimisht thotë: ‘Vendimet përfundimtare të Komisionit janë të detyrueshme për tu zbatuar dhe nuk janë subjekt i rishqyrtimit nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë , rezulton se çështja e ngritur me padi nga paditësi, më nuk mund të rishqyrtohet nga ana e gjykatave, pasi konsiderohet se e njëjta është zgjidhur me vendimet përfundimtare të komisioneve përkatëse të Drejtorisë për Çështje Pronësore Banesore, dhe atë në zbatim të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60. Se vendimet përfundimtare të komisionit të cekur më lartë, të cilat janë marr në përputhje me dy rregulloret e UNMIK-ut (199/13 dhe 2000/60), janë përfundimtare dhe konform nenit 2 parag. 7 të Rregullores 1999/13, të njëjtat nuk mund t’i nënshtrohen rishqyrtimit nga asnjë gjykatë apo organ administrativ në Kosovë, [...]”.*
56. *Në fund, në lidhje me këto pretendime të parashtruesit të kërkesës vendosi edhe Gjykata Supreme, e cila e refuzoi ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi vendimet e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit në lidhje me përtëritjen e procedurës së vitit 1998 për shkak të mungesës së kompetencës.*
57. *Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet Aktvendimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 648/20, ku arsyetohet “se vendimet e kundërshtuara të gjykatave në instanca më të ulëta janë të drejta, pasi që gjykata për çështjen në fjalë nuk ka kompetencë për të vendosur, duke qenë se kjo kompetencë është e rezervuar fillimisht për Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore dhe Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesor, ndërsa pas hyrjen në fuqi të rregullores së UNMIK-ut, 2006/10 dhe 2006/50, ka kaluar në juridiksion të Agjencisë Kosovare të Pronës. Fakti se janë vendosur kërkesat e palëve ndërgjyqësor sipas vendimeve HPCC/D/234/2005/A&C, të datë 16.12.2005 dhe HPCC/REC/71/2006, të datë 06.09.2006, nuk ka qenë përcaktuese për mënyrën e vendosjes sepse përcaktuese është ekzistimi i mekanizmave me kompetenca analoge me gjykatën për çështje të natyrës si kërkesa e paditësit”.*

58. Prandaj, Gjykata konstaton që parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi të përfitojë nga procedura kontradiktore dhe se ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës t'i paraqesë pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e tij; ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare; gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tij, e të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës, dhe se arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kundërshtuar janë paraqitur në detaje, dhe për këtë arsye procedura, e marrë në tërësi, ishte e drejtë (shih: *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30; shih gjithashtu rastin KI22/19, parashtrues *Sabit Ilazi*, aktvendim i 7 qershorit 2019, paragrafi 42 si dhe rasti KI128/18, i cituar më lart, paragrafi 58).
59. Gjykata thekson që në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës, përtej pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i interpretimit të gabuar të ligjit, sepse gjykatat e rregullta i kanë shpallur *res judicata* vendimet e Agjencisë Kosovare të Pronës, nuk mbështet mjaftueshëm dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si ky interpretim i ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta, mund të ketë qenë “qartazi i gabuar”, duke rezultuar në “konkluzione arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme” për parashtruesin e kërkesës apo se si procedurat pranë gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe arbitrare. Përveç kësaj, Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta kanë marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit, pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe kanë arsyetuar të njëjtat dhe qartë kanë arsyetuar se përse i kanë shpallur *res judicata* vendimet e Agjencisë Kosovare të Pronës (Shih: në këtë drejtim, rastin e Gjykatës KI64/20, parashtrues: *Asllan Meka*, Aktvendim për papranueshmëri i 03 gushtit 2020, paragrafi 41 dhe KI22/19, cituar më lart, paragrafi 43).
60. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të interpretimit të gabuar dhe zbatimit të gabuar të ligjit të zbatueshëm janë (i) pretendime që bien në kategorinë e “shkallës së katërt” dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

ii) Sa i përket shkeljeve të pretenduara të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit I të KEDNJ-së dhe nenit 17 të DUDNJ-së

61. Sa i përket shkeljes së të drejtave të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se sipas praktikës së vendosur gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim me kriterin (iii) e pretendimeve “të pambështetura apo të paarsyetuara” kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht:

- a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (shih: në këtë drejtim, rasti i GJEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës (vendim)* nr. 4241/03 i 31 majit 2005, shih gjithashtu *Baillard kundër Francës (vendim)* nr. 6032/04 i 25 shtatorit 2008);
 - b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse vetë Gjykata nuk vendos ndryshe (shih rastin KI166/20, parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, 5 janar 2021, paragrafi 43).
62. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës thjesht ka përmendur shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës, duke arsyetuar *"Gjykatat duke hedhur poshtë padinë si të palejueshme kanë shkelur të drejtën e palës për gjykim të drejtë të garantuar sipas nenit 31, par. 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe të drejtën e tij për mbrojtje të pronës, të garantuar me nenin 46, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Detyrimi i gjykatave për të zgjidhur çështjen kontestuese rrjedh në bazë të nenit 2, par. 3 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore"*.
 63. Sa i përket këtyre pretendimeve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës vetëm i përmend nenet përkatëse të Kushtetutës, por nuk shtjellon më tutje se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e këtyre neneve përkatëse të Kushtetutës. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi në nene të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së dhe përmendja e tyre nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet KI175/20, cituar më lart, paragrafi 81; KI166/20 cituar më lart, paragrafi 52; KIO4/21, cituar më lart, paragrafët 38- 39).
 64. Prandaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës në pronë, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës duhet të deklarohen të papranueshme si qartazi të pabazuara, pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i takojnë kategorisë (iii) së pretendimeve *"të pambështetura ose të paarsyetuara"* sepse parashtruesi i kërkesës thjesht citoi një ose më shumë dispozita të Konventës ose të Kushtetutës, pa shpjeguar se si ato janë shkelur, dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

65. Prandaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 31 dhe 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së, duhet të deklarohen të papranueshme në tërësi si qartazi e pabazuara pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i takojnë kategorisë (i) që kualifikohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; dhe kategorisë së pretendimeve (iii) “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësi duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 7 tetor 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Radomir Laban
Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani
Gresa Caka-Nimani